VENDIM
Nr. 197, datë 18.9.2024

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 175, DATË 4.11.2020, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'TIRANA ENERGJI' SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC 'MALI' ME KAPACITET TË INSTALUAR 1490 kw", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.9.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1815/1 prot., datë 13.9.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 175, datë 4.11.2020, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Tirana Energji' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Mali' me kapacitet të instaluar 1490 kw', i ndryshuar".

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 175, datë 4.11.2020, i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 31.5.2024, ka vendosur të licencojë shoqërinë "Tirana Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Mali", me kapacitet të instaluar 1490 kw, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC "Mali" brenda datës 23.9.2024.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1815 prot., datë 23.8.2024, shoqëria, brenda afatit të vendosur në pikën 3, të vendimit të Bordit të ERE-s, ka depozituar vendimin e Këshillit të Basenit Ujor (KBU) Ishëm, me nr. 10, datë 17.7.2024, për miratimin e "Kërkesës për rinovimin e kushteve të lejes" dhe lejen për përdorim burimi ujor sipërfaqësor nr. 13/8 prot., datë 4.8.2024, me nr. 000078 serie, të miratuar me vendimin e KBU Ishëm me nr. 10, datë 17.7.2024, për prodhim hidroenergjie nga HEC "Mali". Në këtë leje përcaktohet se periudha e vlefshmërisë së saj është për 5 (pesë) vite, deri më datën 17.7.2029.

- Me depozitimin e këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 175, datë 4.11.2020, i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 31.5.2024, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC "Mali", brenda datës 17.7.2029.

- Me ndryshimin e pikës 3 dhe në kuadër të unifikimit me praktikat e tjera të ngjashme, vlerësojmë të ndryshohet dhe pika 4, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 175, datë 4.11.2020, i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 31.5.2024, sikurse shprehur në dispozitiv.

- Në nenin 113, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" është parashikuar mundësia e ndryshimit apo plotësimit të aktit të parë, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 175, datë 4.11.2020, i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 31.5.2024, ndryshon dhe bëhet:

"3. Shoqëria "Tirana Energji" sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC "Mali", brenda datës 17.7.2029.".

2. Pika 4 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 175, datë 4.11.2020, i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 31.5.2024 ndryshon dhe bëhet:

"4. Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 dhe ka një vendim për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti